



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-CC-2024-27

Vendosi: Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese

Gjykatës Vidar Stensland, Kryegjykatës

Gjykatës Rumen Nenkov

Gjykatëse Romina Inkuti

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 17 tetor 2024

Gjuha: Anglishte

Titulli i dosjes: Kërkesë Referuese e Salih Mustafës drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Shkeljen e Pretenduar të të Drejtave të Tij Themelore të Garantuara nga Nenet 22, 31 dhe 33 të Kushtetutës së Kosovës dhe Nenet 6 dhe 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Gjuhën e Punës dhe Procedurën e Mëtejshme

Parashtruesit

Salih Mustafa

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Viktimave

Ani Puz

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 27 shtator 2024, z. Salih Mustafa ("parashtruesi") i dorëzoi Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese kërkesë referuese (përkatësisht, "DHSGJK" dhe "Kërkesa Referuese")¹ bazuar në nenet 22, 31 dhe 33 të Kushtetutës së Kosovës, nenin 49(3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullën 20 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"). Parashtruesi përfaqësohet nga z. Julius von Bone.
2. Më 3 tetor 2024, Kryetarja e Dhomave të Specializuara, në pajtim me nenin 33(3) të Ligjit, caktoi Panelin e mësipërm për të vendosur në lidhje me Kërkesën Referuese.²
3. Më 3 tetor 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") kërkoi t'i lejohet të bëjë parashtrime ("Kërkesa e ZPS-së") meqenëse "Kërkesa Referuese buron nga aktakuza, gjykimi dhe apeli në procesin e çështjes *Prokurori i Specializuar k. Salih Mustafës* dhe ka të bëjë me aspekte të trajtuara në ballafaqimin juridik mes palëve në atë proces".³ ZPS-ja argumenton se, për këtë arsye, "ka interes të drejtpërdrejtë dhe preket drejtpërdrejt nga lënda e Kërkesës Referuese".⁴ ZPS-ja kërkon që, nëse i miratohet leje për t'iu përgjigjur Kërkesës Referuese, të lejohet të përgjigjet deri më 8 nëntor 2024, duke marrë parasysh "kuadrin, rëndësinë dhe kompleksitetin e pikave të ngritura në Kërkesën Referuese".⁵
4. Më 6 tetor 2024, parashtruesi kundërshtoi Kërkesën e ZPS-së, duke argumentuar se neni 35(2)(i) i Ligjit më vete nuk i jep ZPS-së autoritet për të bërë asnjë lloj kërkesë

¹ F00001, Kërkesë Referuese drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Shkeljen e të Drejtave Themelore të z. Salih Mustafa të Garantuara nga Nenet 22, 31 dhe 33 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Nenet 6 dhe 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me Shtojcat publike 1 deri 7, 27 shtator 2024.

² F00002, Vendim për Caktimin e Gjykatësve të Panelit të Gjykatës Kushtetuese, 3 tetor 2024.

³ F00003, Kërkesë e Prokurorisë për Autorizim për t'iu Përgjigjur Kërkesës Referuese KSC-CC-2024-27/F00001, 3 tetor 2024, para. 2.

⁴ Kërkesa e ZPS-së, para. 2.

⁵ Kërkesa e ZPS-së, para. 3.

referuese ("Parashtrimi i Parashtruesit").⁶ Për më tepër, parashtruesi argumenton se Kërkesa Referuese ka të bëjë me të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe, për rrjedhojë, nuk lidhet me punën e institucionit të ZPS-së.⁷

5. Më 10 tetor 2024, Mbrojtja e Viktimave kërkoi t'i miratohet leje për t'u përgjigjur ndaj Kërkesës Referuese dhe ka për qëllim të sigurojë se e drejta e viktimave për njoftim është e garantuar ("Kërkesa e Mbrojtjes së Viktimave").⁸ Sipas Mbrojtjes së Viktimave, viktimat kanë të drejtën e njoftimit që vlen për të gjitha fazat e procesit.⁹ Gjithashtu, Mbrojtja e Viktimave argumenton se parashtruesi "sulmon drejtpërdrejt kuadrin e pjesëmarrjes së viktimave" dhe rrjedhimisht prek "drejtpërdrejt thelbin e mënyrës se si viktimat mund të veprojnë për të garantuar të drejtat e tyre në proces, të përcaktuara në nenin 22 të Ligjit".¹⁰

6. Më 14 tetor 2024, z. Mustafa dorëzoi kundërshtimin e tij ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Viktimave ("Kundërpërgjigjja e Mustafës ndaj Mbrojtjes së Viktimave"), ku, ndër të tjera, parashtroi se Kërkesa Referuese ka të bëjë me të drejtat e tij individuale dhe "nuk ka për qëllim të shërbejë si një mundësi shtesë apo më vete që viktimat, apo ndonjë palë tjetër, të bëjnë komente për Kërkesën Referuese të Mustafës".¹¹

II. VLERËSIMI I PANELIT

7. Sipas nenit 20 të Ligjit dhe rregullës 5 të Rregullores, Paneli vendos gjuhët e

⁶ F00004, Përgjigje e Mustafës ndaj Kërkesës së ZPS-së për Autorizim për t'iu Përgjigjur Parashtrimit KSC-CC-2024-27/F00003 (Kërkesa Referuese e Mustafës), 6 tetor 2024, para. 14.

⁷ Parashtrimi i Parashtruesit, para. 15. Shih gjithashtu Parashtrimin e Parashtruesit, para. 16-20, 23-24.

⁸ F00005, Kërkesë e Mbrojtjes së Viktimave për Leje për Dorëzimin e Parashtrimeve ndaj Kërkesës Referuese të Mustafës drejtuar Gjykatës Kushtetuese, 10 tetor 2024, para 3.

⁹ Kërkesa e Mbrojtjes së Viktimave, para. 4-5.

¹⁰ Kërkesa e Mbrojtjes së Viktimave, para. 6. Shih gjithashtu Kërkesën e Mbrojtjes së Viktimave, para. 7-8.

¹¹ F00006, Përgjigje e Mustafës ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Viktimave për Leje për Dorëzimin e Parashtrimeve ndaj Kërkesës Referuese të Mustafës drejtuar Gjykatës Kushtetuese, 14 tetor 2024, para. 19.

punës për procedurat para tij. Meqenëse parashtruesi e ka bërë Kërkesën Referuese në anglishte, gjuha e punës e kësaj procedure do të jetë anglishtja, me përkthim zyrtar me shkrim ose me gojë në gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara, të mundësuar nga Zyra Administrative.

8. Lidhur me kërkesat për të bërë parashtrime, Paneli dëshiron të theksojë se procedura në DHSGJK nuk është ballafaquese dhe trajton vetëm shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut. Për këtë arsye, nuk ka “palë” në proces dhe nuk ekziston e drejtë e vetvetishme për të dorëzuar parashtrime apo përgjigje ndaj kërkesës referuese të një parashtruesi. Me fjalë të tjera, Paneli do të kërkojë parashtrime nga ZPS-ja ose të tjerët vetëm nëse e gjykon të nevojshme në kontekstin e kërkesës referuese në fjalë.

9. Paneli shqyrtoi Kërkesën e ZPS-së dhe e gjykon të përshtatshme në rrethanat aktuale të bëjë një përjashtim e të marrë parashtrime nga ZPS-ja për Kërkesën Referuese në bazë të rregullës 15(2) të Rregullores, si dhe nga parashtruesi në përgjigje të atyre parashtrimeve.

10. Paneli shqyrtoi gjithashtu edhe Kërkesën e Mbrojtjes së Viktimave dhe, pa paragjykuar konstatimet në lidhje me Arsyen 1 të Kërkesës Referuese, e gjykon të përshtatshme të bëjë një përjashtim e të marrë parashtrime sipas rregullës 15(2) të Rregullores vetëm sa i takon kuadrit të pjesëmarrjes së viktimave.

PËR ARSYET E LARTPËRMENDURA,

Paneli i Gjykatës Kushtetuese

1. *Vendos* që gjuha e punës e kësaj procedure të jetë anglishtja, me përkthim zyrtar me shkrim ose me gojë në gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara – përkatësisht në shqipe, serbishte dhe anglishte – të mundësuar nga Zyra Administrative;
2. *Miraton* Kërkesën e ZPS-së;

3. *Miraton* Kërkesën e Mbrojtjes së Viktimave;
4. *Vendos* që ZPS-ja mund të dorëzojë parashtrime prej jo më shumë se 20 faqesh në përgjigje të Kërkesës Referuese, deri më 8 nëntor 2024;
5. *Vendos* që Mbrojtja e Viktimave mund të dorëzojë parashtrime vetëm në lidhje me të drejtën e viktimave për pjesëmarrje, dhe që këto parashtrime, nëse do të ketë, duhet të jenë prej jo më shumë se 10 faqesh; dhe
6. *Vendos* që parashtruesi mund të dorëzojë kundërpërgjigje ndaj parashtrimeve të ZPS-së dhe Mbrojtjes së Viktimave, nëse do të ketë, prej jo më shumë se 25 faqesh, deri më 29 nëntor 2024.

/nënshkrimi/

Vidar Stensland
Kryegjykatës

Përpiluar në anglishte, e enjte, 17 tetor 2024
Në Hagë, Holandë